



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
Odeljenje za Privredu, Razvoj i Turizam
Department of Economy, Development and Tourism

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES/KABINET PREDSIEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 3062 Nr. i faq/Br.str/No.pg 18
Data/Datum/Date 10 / 9 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC



DATË /A:	18.09.2023
PËR/ZA/TO :	z.Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit
NGA/OD/FROM:	z.Erhan Morina, Drejtor për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
LËNDA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport i punës për periudhën janar-shtator 2023

DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM

Gjatë periudhës janar-mars të 2023, DEZHT-i ka bërë regjistrimin e të gjitha subjekteve afariste prej librit kryesor të vitit 2022 në librin e ri të vitit 2023, poashtu është bërë edhe kalkulimi i ngarkesave për vitin 2023.

Për periudhën raportuese Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm ka përgatitur disa pika drejtuar Kuvendit Komunal në Rahovec:

- Informatë mbi menaxhimin e aseteve komunale për vitin 2022;
- Plotësim-ndryshimi i rregullores për taksa komunale 01 Nr. 80/20;
- Shfuqizimi i vendimit për fabrikën e kartonit, si dhe vendimi për dhënjën në shfrytëzim përmes shprehjes së interesit;
- Falja e borxheve të vjetra në taksa afariste për periudhën 1.1.2000-31.12.2017;
- Vendimi për dhënjën në shfrytëzim përmes ankandit publik të 4 parcelave te depot e Matreksit në Xërxë. Në këtë ankand ka pasur një aplikant i cili tashmë ka kontratë;
- Vendimi për dhënjën në shfrytëzim të lokaleve te palestra "Mizahir Isma", ku në këtë ankand kapasur vetëm një aplikant i cili tashmë ka kontratë me K.K Rahovec;
- Vendimi për dhënjën në shfrytëzim të tregut ditor në fshatin Raktkoc;
- Vendimi për këmbim të dy parcelave të cilat gjenden te Parku Idustrial në Opterushë, për të cilat jemi në pritje të ligjshmërisë nga MAPL.

Janë mbajtur 3 sesione informuese:

- Sesion informues rreth aplikimit për grante në fondet të IPA-s;
- Sesion informues për grante. Ky sesion informues është organizuar nga Syri Vizion në bashkëpunim me DEZHT-in;
- Sesion informues për thirrjen e granteve për bizneset të cilën e ka hapur Ministria e Zhvillimit Rajonal. Ky sesion informues u organizua nga DEZHT-i, në bashkëpunim me Agjencionin Zhvillimor Rajonal.

- Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) në bashëpunim me DEZHT-in, ka ndarë 66 kupon me vlerë nga 100.00€ deri në 300.00€, për familjet e prekura nga vërshimet, të cilat janë kushte jo të mira ekonomike;
- Është mbajtur takimi i i dytë këshillit publiko-privat, ku u diskutuan qështje të ndryshme rreth zhvillimit ekonomik lokal në Rahovec;
- Është inicuar ankandin publik për shitjen e aseteve të pa përdorëshme të komunës. Përmes këtij ankandi u mundësua shitja e shumë asteve të cilat nuk janë përdorur për arsye të dëmtimeve dhe vjetërsisë. Vlera e aseteve të shitura është 12,950.00€
- Me datë 27 dhe 28 Prill, kemi marrë pjesë në Panairin Ndërkombëtarë të Turizmit, i cili u mbajt në Prishtinë. Në këtë panair u prezantuan monumentet e trashëgimisë kulturore si dhe pikat turistike të komunës së Rahovecit. Në këtë panair, bashkë me ne, ishte edhe pronari i bodrumit Kosova Wine.
- Me datë 15 maj 2023, kemi marrë pjesë në konferencën Diaspora Flet, ku kemi prezantuar projektin e Parkut Industrial në Opterushë, projekt ky i cili do të ndihmoj në rritjen e zhvillimit ekonomik të komunës sonë;
- Në qershor, është hapur thirrja për praktikant me pagesë në partneritet publiko-privat ku 37 aplikant kanë plotësuar kriteret për mbajtjen e praktikës. Aktualisht është mbyllur thirrja për ofertim nga bizenset dhe komisioni është duke shqyrtuar aplikacionet.
- Në shtator K.K Rahovec, aplikuar në thirrjen për grante të cilën e ka hapur Ministria e Zhvillimit Rajonal. Në këtë thirrje Komuna e Rahovecit ka aplikuar me dy projekte:
 1. Ballkoni panoramik dhe
 2. Terrenet sportive.

Investimet Kapitale:

- Me 27.03.2023 ka filluar faza e parë e ndërtimit të Parkut Industrial në Opterushë, ky projekt bashkëfinancohet nga MINT dhe Komuna e Rahovecit, i cili arrin shumën 1,688,216.52€. Punimet në këtë projekt janë duke u realizuar sipas planit dinamik;
- Është përfunduar projekti: “Rregullimi i Oborrit të Depotit të Mtreksit në Xërxë”;
- Në projektin: “Ndërtimi i Lokaleve Afariste Zejtare në Rahovec”, ka përfunduar ndërtimi i vrazhdë, është vendosur instalimi elektrik, instalimi ujit, janë kryer punët me suvatim, aktualisht ka mbetur për tu realizuar pozicioni i dritareve;
- Me 31.08.2023, është bërë përfundimi i shtëpisë për të Moshuar.

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

Sektori për Ekonomi:

Në tre mujorin e parë të vitit 2023 janë përgatitur aktvendimet për të gjitha bizneset që janë të ngarkuara me taksë afariste komunale dhe poashtu kemi vazhduar me inkasimin e të hyrave në këtë sektor.

Të hyrat dhe ngarkesa në taksë komunale;

Nr.	Përshkrimi	Vlera në €
1	Të hyrat në taksë komunale, periudha janar-shtator 2023	55,850.50€

Sektori për Zhvillim;

Evidenca e të hyrave dhe ngarkesës së qirasë të lokaleve afariste dhe pronës së paluajtshme të Komunës së Rahovecit, sipas bazës së shfrytëzimit si pasuri e paluajtshme komunale me të cilat disponon komuna e Rahovecit, mbahet në mënyrë të rregullt.

Në periudhën janar-shtator 2023, janë lëshuar gjithsej 105 pëlqime të punës.

Të hyrat nga qiraja;

Nr.	Përshkrimi	Vlera në €
1	Të hyrat nga qiraja për periudhën janar- shtator 2023	75,015.91 €

Zyra e QKRB-së:

Raporti është i bazuar në planifikimin, objektivat dhe detyrat e punës. Evidenca e regjistrimit të bizneseve të komunës së Rahovecit, sipas bazës së programit online të ARBK-ës, mbahet në mënyrë të rregullt.

Tabela e kërkesave dhe e regjistrimit të bizneseve për periudhën janar-shtator 2023:

Nr.	Përshkrimi	Nr.
1	Biznese të reja	120
2	Informata të ndryshme	134
3	Vërtetim Individual	33
4	Biznese të njësisë	5
5	Shuarje të biznesit	29
6	NUI	36
7	Ndryshim statuti nga B.I në SH.P.K	03
8	Ndrrim të emrit tregtarë dhe informata të tjera	02
9	Ndrrim i pronarit, shtim i pronarëve	82
10	Certifikat e dëmtuar	10
	Gjithsej lënd të përfunduara	454

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

Menaxhimi i Asteteve komunale

Të gjitha transaksionet që kanë ndodhur gjatë vitit 2023, janë regjistruar me kohë në sistemin e-pasuria dhe SMFK, dhe regjistrimi i tyre bëhet në vazhdimësi.

Sektori i Turizmit

Zyra për Informacione Turistike, gjegjësisht Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, i ka zbatuar detyrat dhe obligimet e muajit janar-shtator, 2023 si në vijim:

- Janë mbajtur takime të rregullta me organizaten e UNDP-së në lidhje me projektin për Programin Rajonal 2, ReLOad2.
- Në kuadër të turizmit, është lansuar Harta Turistike Dixhitale në komunën e Rahovecit, ku përmes sistemit CR cod, mundësohet promovimi i atraksioneve turistike dhe monumenteve të trashëgimisë kulturore. Kjo hartë është e pasuruar me 108 objekte turistike dhe kulturore.
- Ka përfunduar thirrja e dytë e projektit të Reload2, në kuadër të UNDP-së dhe Komunës së Rahovecit, në këtë thirrje aplikuan 10 biznese me projektet e tyre, ku 6 prej tyre kanë kaluar.

Me respekt!

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm